
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>01-791</p> 
-----------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-60498/24 dt. 10.05.2024, të kërkesit/ pronarëve Naser Krasniqi, Demir Krasniqi, Isak Krasniqi, Hazbi Krasniqi, Ismet Krasniqi, Ramadan Makolli, Bekim Nika, Burim Potera, Sajmir Konushefci dhe Bekim Xhemajli, që të gjithë nga Prishtina, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, “Linda Premium Residence”, përkatësisht Ndërtesa “A” e ndërtuar në kuadër të Bllokut urban “E-5” të Tërësisë “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, në rr. “Shkupi”, dhe “Besim Vitia”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 16.09.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkesit/ pronarëve Naser Krasniqi, Demir Krasniqi, Isak Krasniqi, Hazbi Krasniqi, Ismet Krasniqi, Ramadan Makolli, Bekim Nika, Burim Potera, Sajmir Konushefci dhe Bekim Xhemajli, që të gjithë nga Prishtina, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-60498/24 dt. 10.05.2024, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, “Linda Premium Residence”, përkatësisht Ndërtesa “A” me etazhitet 2B+S+P+8, e ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05 Nr. 351/02-159162/17 dt. 06.12.2017, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelen kadastrale nr. 10171-3, ZK Prishtinë, në kuadër të Bllokut urban “E-5” të Tërësisë “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim” në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Shkupi”, ku kanë dalje hyrjet me numrat: 108, 110, 112, 114, 116, 118, 120, 122, 124, 126, 128, 130, 132, 134 dhe 140, në Prishtinë, dhe në rrugën “Besim Vitia”, ku kanë dalje hyrjet me numrat: 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 29 dhe 31, në Prishtinë të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Arsyetim

Kërkuesit/ pronaret Naser Krasniqi, Demir Krasniqi, Isak Krasniqi, Hazbi Krasniqi, Ismet Krasniqi, Ramadan Makolli, Bekim Nika, Burim Potera, Sajmir Konushfeci dhe Bekim Xhemajli, që të gjithë nga Prishtina, me investitor "Al-Trade Center" shpk me seli në Glllogoc, ne rr. "Jasharajve", pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-60498/24 dt. 10.05.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, "Linda Premium Residence", përkatësisht Ndërtesa "A" me etazhitet 3B+S+P+7, e ndërtuar në kuadër të Bllokut urban "E-5" të Tërësisë "E", të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parces kadastrale nr. 10171-3, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas "Vendimit të Lejes Ndërtimore" 05 Nr. 351/02-159162/17 dt. 06.12.2017, të lëshuar nga Drejtorja e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtorja e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-45090/24 dt. 03.04.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Labinot Bashota; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Ilir Babaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Astrit Salihu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Abaz Kelmendi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Artan Dashi; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Valon Ajazi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike dhe instalimet e makineris, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për



lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.


Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesën shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-60498/24 DT. 16.09.2024

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu


Udhëheqëse e Sektorit
Nazife Krasniqi



